



Nr. Ref. BD-207/1

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 07 dhe 08 gusht 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Menaxhmentit të AKP-së dhe amendamentohet Rregullorja Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore respektivisht neni 10 që i referohet qiradhënies direkte me propozimin si në vijim:

10.1.4 Kur paraqitet kërkesë për qiramarrje nga palët e interesuara, me arsyeshmëri konkrete të ndikimit në mirëqenie dhe zhvillim ekonomik e social, arsyeshmëri kjo e mbështetur formalisht nga institucionet qendrore përkatëse të vendit, respektivisht qeveria, ministritë relevante i shtohet edhe fjalia “ose komunat respektive”.

- II. Gjithashtu shtohet paragrafi i ri: neni 10.1.8 Përjashtimisht rasteve të cekura në paragrafët e mësipërme të nenit 10 të kësaj rregullore, Bordi i Agjencisë kosovare të privatizimit mund të zbatoj qiradhënien direkte edhe kur palët e treta apo individët shprehin interes me shkrim për të marr me qira asete të NSH-se, atëherë vendimi për dhënien me qira direkte për palën e tretë merret duke marr parasysh interesin më të mirë për NSH-në.
- III. Përpos rekomandimeve të lartcekura nenet tjera të Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, mbesin të pandryshuara. Andaj me këtë vendim aprovohet Rregulloja nr.02/2024 për qiradhënien e asetëve të NSH-ve.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për amendamentimin e Rregullores për qiradhënie të asetëve të NSH-ve nr.07/2023 e datës 28 shtator 2023.

Ky vendim është aprovuar duke pas parasysh faktin se në vazhden e aktiviteteve të Agjencisë-së dhe/apo të Autoritetit të Likuidimit përkatës, me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës së asetëve si dhe të hyrave për t’iu ndarë kreditorëve të NSH-ve dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë ndërmarrin veprime për qiradhënien e asetëve të caktuara të NSH-ve përkatëse. Meqë AKP ka pranuar kërkesa për qiramarrje nga Komunat dhe organet si dhe palët që kanë shprehur interes për qiramarrje direkte me arsyeshmëri në mirëqenien dhe zhvillim ekonomik të vendit, paraqitet nevoja e amendamentimit të nenit 10 të Rregullores Nr 07/2023 për Qiradhënien e Asetëve të NSH-ve sikurse është përshkruar në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 07 gusht 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-207-2

Në bazë të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe bazuar në Rregulloren nr. 6/2023 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së lidhur me Njësitë 3 dhe 4 të transaksioneve të Ndërmarrjeve Shoqërore SHAL 66, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datat 07 dhe 08 gusht 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Anulohet shitja e Njësisë nr. 03 – SHAL 66: Fabrika e Plastikës Parcela 00690-0 me palën me çmim 232,220 €.
- II. Anulohet shitja e Njësisë nr. 04 – SHAL 66: Fabrika e Plastikës Parcela 00691-0 me palën me çmim 81,490 €.
- III. Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së që asetet e sipër cekura t'i tenderojë sërish në një fazë të mëvonshme sipas planit dinamik të Menaxhmentit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

A R S Y E T I M

Bordi sipas procedurave me datë 30 korrik 2024 ka marr vendim për aprovimin e Njërive numër 3 dhe 4 që kanë pranuar oferta në Shitjen e Aseteve 66. Në mbledhjen e datës 07 gusht 2024 Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar propozimin e Menaxhmentit për rishikim e vendimeve në fjalë.

Pas mbledhjes së datës 30 korrik 2024, Menaxhmenti ka vërejtur se për Njësitë numër 3 dhe 4 nuk janë pasqyruar informatat e mjaftueshme ose të ngjashme si për asetet tjera që kanë qenë në këtë valë të shitjes. Për më tepër në ortofoto nuk është pasqyruar se asetet gjenden brenda qytetit, dhe nuk shpjegohet në tekst afërsia me zonën e ndërtimit e cila është rreth 150m larg këtyre aseteve.

Gjithashtu në asetin me nr. 20 të SHAL 66, pasqyrimi është shumë më i detajuar kur shpjegohet aset i që sipas kategorizimit është: pronë bujqësore – livadh, por vlerësimi rekomandohet të bëhet për pronë ndërtimore me çmim të rekomanduar për shitje shumë më të lartë, që do të duhej të ishte i njëjti rekomandim edhe për Njësitë me numër 3 dhe 4.

Meqë Njësitë 3 dhe 4 të SHAL 66 janë në largësi prej rreth 150 m nga zona ndërtimore dhe sipas emiores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve, në analogji me Njësinë Nr. 20 të të njëjti ShAL vlerësimi do të duhej të ishte për tokë ndërtimore me çmim prej: 18,000.00 euro për ari. Dhe për këtë çmimi orientues i paraqitur në dokumente të prezantuara për aprovim të shitjes së aseteve me nr. 3 dhe 4 nuk ka qenë korrekt.

Pas vlerësimeve në fjalë rezulton se të dy Njësitë konsiderohen si tokë ndërtimore dhe rrjedhimisht bazuar në Nenin 14.3.1 të Rregullave të Tenderit, pasi që çmimi i pranuar është më i ultë se çmimi orientues, nëse Bordi do ti kishte parasysh të dhënat e sipër cekura në mbledhjen 30.07.2024 do te ishte refuzuar shitja e këtij aseti.

Duke u bazuar në faktet e mësipërme Bordi ka rishqyrtuar propozimin e menaxhmentit mbi faktet dhe argumentet e reja të parashtruara, të cilat ndikojnë në mënyrë esenciale në vendimet e datës 30 Korrik 2024.

MH



Ky vendim është marr duke u bazuar në nenin 16.3.1 të Rregullave të Tenderit.

Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 07 gusht 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-207/3

Në bazë të neneve 15.2.16 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së Qeverisë Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues dhe Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 07 dhe 08 gusht 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Amadamentohet paragrafi II i vendimit të Bordit Nr. Ref. BD-185/5 i datës 21 gusht 2023, respektivisht mandati i Komisionit është deri në përfundim të mandatit si anëtar të Bordit pra deri me datë 05 gusht 2025.
- II. Z. Halim Muçolli emërohet Kryetar i Komisionit, anëtarët tjerë janë të njëjtë sikurse kanë qenë:
 1. Z. Gent Nushi, Anëtar
 2. Z. Avni Ajdini, Anëtar
- III. Kompensimi për angazhimin në këtë komision për Kryesuesin është 200 € në muaj, ndërkaq për anëtarët kompensimi është 150 € në muaj deri në përfundim të mandatit sipas datës së lartcekur.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


ARSYETIM

Ky vendim aprovohet në bazë të neneve 15.2.16 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores së Qeverisë Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues si dhe Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197.

Duke qenë se Komisionit të Bordit për vlerësim dhe raportim të punës së Menaxhmentit të Agjencisë, në bazë të paragrafit III të dispozitivit të Vendimit të Bordit të AKP-së me Nr. Ref. BD-185/5 i datës 21 gusht 2023, i përfundon mandati me datë 31 gusht 2024 dhe duke qenë se Kryetarja ka dhënë dorëheqje, duke qenë se pozita e kryetarit ka mbetur vakante, Bordi shqyrtoi propozimin dhe vendosi si paragrafin I dhe II në dispozitiv të vendimit.

Prishtinë, më 07 gusht 2024




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-207/4

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; Nenit 10. 1.8 i Rregullores për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve aprovuar me datë 07.08.2024, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me 07 dhe 08 gusht 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte të lokalit afarist në Mitrovicën e Veriut në sipërfaqe prej 64.46 m2 për kompaninë e sigurimeve "Eurosig" përfaqësuar nga Gëzim Tola sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 220 Eur/muaj për asetin e Borac Travnik – Aseti, PRZ080.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se me datë 30.07.2024 është pranuar kërkesa nga ana e Kompanisë së Sigurimeve "Eurosig" përfaqësuar nga Gëzim Tola për qiramarrjen e lokalit afarist me sipërfaqe prej 64.46 m2 i cili gjendet në Mitrovicën e Veriut. Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 333/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalin afarist me sipërfaqe prej 64.46 m2 i cili gjendet në Mitrovicën Veriore është në shumën prej 220.00 Euro/muaj.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posëme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 08 gusht 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-207/5

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlihen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; Nenit 10. 1.8 i Rregullores për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve aprovuar me datë 07.08.2024, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me 07 dhe 08 gusht 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte të lokalit afarist në Mitrovicën e Veriut në sipërfaqe prej 64.3 m² për kompaninë "Misini" përfaqësuar nga Lindrit Misini sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 220 Euro/muaj për asetin e NSH Inkol Leskovac, MIT161
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.


Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se me datë me datë 29.07.2024 është pranuar kërkesa nga ana e Kompanisë "Misini" përfaqësuar nga Lindrit Misini për qiramarrjen e lokalit afarist me sipërfaqe prej 64.3 m² i cili gjendet në Mitrovicën e Veriut. Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 331/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalit afarist me sipërfaqe prej 64.3 m² i cili gjendet në Mitrovicën Veriore është në shumën prej 220.00 Euro/muaj.


Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 08 gusht 2024


Menfor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-207/6

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërliidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; Nenit 10. 1.8 i Rregullores për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve aprovuar me datë 07.08.2024, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me 07 dhe 08 gusht 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte të lokalit afarist në Mitrovicën e Veriut në sipërfaqe prej 84.3 m² për kompaninë "Misini" përfaqësuar nga Lindrit Misini sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 300 Eur/muaj për asetin e NSh Pllanika Kranj, MIT156
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.


Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se me datë 29.07.2024 është pranuar kërkesa nga ana e Kompanisë "Misini" përfaqësuar nga Lindrit Misini për qiramarrjen e lokalit afarist me sipërfaqe prej 84.3 m² i cili gjendet në Mitrovicën e Veriut. Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 331/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalin afarist me sipërfaqe prej 84.3 m² i cili gjendet në Mitrovicën Veriore është në shumën prej 300.00 Euro/muaj.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 08 gusht 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

